



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË**

**V E N D I M**

Nr. 104, Datë 14.04.2021

**PËR MIRATIMIN E VEPRIMTARISË JASHTË FUNKSIONIT**

Bazuar në gërmën “ç”, të nenit 149 të Kushtetutës të Republikës të Shqipërisë, nenin 9 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, gërmën “a”, të pikës 1 të nenit 189 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, dhe nenin 8 të Rregullores “Për veprimtaritë jashtë funksionit të prokurorëve”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë pasi u njoh me kërkesën nr. prot. 884, datë 01.04.2021 dhe Relacionin e përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik dhe i Buxhetit.

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e veprimtarisë jashtë funksionit për prokuroren znj. Enkeleda Millonai, si eksperte/lektore, në trajnimin që do të organizohet nga Komisioni i Policisë Gjyqësore në bashkëpunim me Akademinë e Sigurisë, për trajnimin fillestar të oficerëve të policisë gjyqësore të emëruar rishtaz nga Komisioni i Policisë Gjyqësore për Seksionet e Policisë Gjyqësore të Prokurorisë, në lidhje me fazën e hetimit. Trajnimi do të zhvillohet më datë 14.04.2021 dhe 21.04.2021 dhe do të përbëjë në total 7 ore leksione.
2. Veprimtaria jashtë funksionit të mos ushtrohet me shumë se 2 orë gjatë orarit të punës.
3. Të njoftohen për këtë vendim znj. Enkeleda Millonai dhe Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

**KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË**

**KRYETAR  
GENT IBRAHIMI**

**ZV/KRYETAR  
ALFRED BALLA**



**ANËTAR  
KOSTAQ BELURI**



**ANËTAR  
BUJAR SHESHI**



**ANËTAR  
NURIHAN SEITI**



**ANËTAR  
SANDËR BECI**



**ANËTAR  
VATË STAKAJ**



**ANËTAR  
TARTAR BAZAJ**



**ANËTAR  
ESMERALDA KESHI**



**ANËTAR  
MOISI DUDA**



**ANËTAR  
ELOIDA GOXHI**

